



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PESTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **19.06.2026 (e premte)**, në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Basri Aliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Elsa Jahija, ndërsa mungoi, zn.Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se janë prezent të gjithë anëtarët e KPF-së dhe ka kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e Komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e pestë të rregullt të KPF-së. Pra, materialin e keni marrë me kohë. Para se me hy në rend të ditës aktet e ligjshmërisë, ato çka kanë kalu 30 ditë janë publiku, e kemi obligim komiteti me mbajtë një dëgjim buxhetor para seancës. E kemi thirrë dëgjimin buxhetor për të premtën e ardhshme, ju kisha kërku me ardh. Ju uroj për krejt këto pjesët e manifestimit që kanë qenë në muajin qershor, kush ka mundë ju ka përgjigj që me qenë prezent. E dimë që kemi edhe një seancë pa mbajtë, po mendoj që të njëjtën ditë me vazhdu atë seancë masdite. Perfaqësuesi i OSBE-së është ndryshu, sepse z.Irfani më ka thirrë në telefon më ka falenderu për bashkëpunimin, por përfaqësuesin e ri ende nuk e kam taku. Hapi diskutimin para se me hy në rend të ditës, pasi që nuk ka për diskutim, për këtë seancë kemi parapa këtë rend të ditës:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2027-2029.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2027.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale në pronën komunale, Vendimi me Nr.01-110/05-487, i datës 04.05.2026.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te rendi i ditës, nga ministria kemi pas të kthyer një pikë që kemi bërë atë pjesën e rruges, kemi miratu vendimin për hapjen e rrugës. Ministria na ka kthyer për plotësim ndryshim, sepse nuk kanë qenë të kompletura disa matje, disa pika, deri kur e kmei thirrë seancën, Drejtoria e Urbanizmit nuk e ka bërë materialin. Për shkak të aspektit ligjor kam kërku shfuqizimin e vendimit, sepse aspekti ligjor na thotë që, brenda

30 dite duhet me shfuqizu, ndersa për sot veç këta e kanë përgatit materialin. Unë ju kam thanë edhe atë ditë, se mos e përgatitni deri në Kuvend. Ne prej shfuqizimit e kthejmë në plotësim ndryshim. Te pika 4, ku kemi propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin. E jekim këtë pikë e shtimë pikën për ndryshim plotësim. Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet rendi i ditës me ndryshim të pikës së katër, prej shfuqizim të vendimit në plotësim ndryshim të vendimit. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katër e Komitetit për Politikë dhe Financa

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A ka me diskutu për këtë pikë? Jo. Nga të gjithë të pranishmit u miratu procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2027-2029

zn.Milohate Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. KAB-i është dokument i cili paraqitet nga zyrtarët e administratës komunale pas pranimi të qarkores buxhetore nga Ministria e Financave, ku janë paraqitur kufijtë fillestarë të buxhetit për vitet 2027, 2028 dhe 2029. Ky dokument miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme, në të cilën përcaktohen parametrat kryesorë për zhvillimin e shpenzimeve publike. Duhet ta dini se në këtë material janë paraqitur kufijtë buxhetorë. Ne duhet, nëpër kategori, me kqyrë ku kemi më së shumti nevojë dhe ku kemi më shumë obligime, e në bazë të kësaj i kemi caktuar ndarjet, aq sa e kemi buxhetin. Pasi që materialin e kemi marrë me kohë, nuk do t'ju marr kohë duke e lexuar, por për çdo sqarim shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Ilir Zuka: Pata një propozim. Kur të vijë koha e dëgjimeve buxhetore, në ato fshatra ku nuk është mbajtur asnjëherë një dëgjim buxhetor, të mbahen dëgjimet aty. Ne e kemi lokalitetin e Pozheranit, ku është mbajtur edhe më herët, por unë them që, në vend se të mbahet në Pozheran, të mbahet në lokalitetin e Sllatinës, ku përfshihen edhe pesë fshatra të tjera.

z.Jakup Demiri: Te grandit i përgjithshëm është shënuar rritje. Te pika e dytë, grandit specifik (nuk dëgjohet), a mundemi me ditë sa kemi borxhe, që me mujtë me i reduktu investimet kapitale për shkak të borxheve që janë të mbledhura (nuk dëgjohet)? Gjithashtu, sa i përket dëgjimeve publike, kisha thanë që të lajmërohen administratorët e fshatrave dhe këshillat e fshatrave që me qenë prezentë, sepse për listën e investimeve apo nevojat që i kanë, ata i dinë më së miri. Takimi me qytetarë është bërë problem. Pyetjet e tjera që i kam, do t'i parashtoj në Kuvend.

z.Ilir Zuka: Kur u cekën administratorët e fshatrave, Drejtoria e Shërbimeve Publike, për me i ndalë harxhimet, domethënë edhe ato pak 10 euro që kanë qenë, ua kanë ndalë.

zn.Liridona Bislimi: Dashta me u ndërlidh te kjo pjesa e diskutimeve publike që bëhen. Është mirë me i kushtu një rëndësi më të madhe dhe me e ndryshu strategjinë. Ndoshta është mirë, sidomos ne që jemi pjesë e komitetit, me pas një lloj pasqyrimi se deri tani, ta zëmë shembull, në filan fshat apo lagje është bërë një kërkesë përmes një diskutimi publik, e cila është përsëritur e ripërsëritur. Unë po flas tash si përfaqësuese e fshatit Drobesh. Ka ndodh vazhdimisht në takime që kanë ardhë përfaqësuesit e fshatit dhe kërkesat kanë qenë të njëjtat. Mandej kjo e ka edhe koston e vet, për shkak se përfaqësuesit ose banorët e atij lokaliteti po mendojnë që ky diskutim nuk e ka asnjë vlerë, sepse nuk merren parasysh kërkesat e tyre. E kam përmend disa herë dhe prap po e përmend. Ka pasur rast që ka pasur kërkesë nga një lagje ku ka pasur numër të konsiderueshëm të fëmijëve, të cilët kanë kërku ndriçim publik, por është bërë në një rrugicë tjetër, e cila veç sa është ndërtuar dhe ku ka pasur shumë më pak banorë. Sa i përket administratorëve të fshatrave, ju me i njoftu i njoftoni, por ata

aktualisht e ndiejnë veten jo legjitimë për pozitën që e kanë, për shkak se atyre u ka kaluar mandati që një kohë të gjatë. Kjo neglizhencë e jona si institucion ua krijon përshtypjen që mos me marrë pjesë ose mos me u interesu, dhe me të drejtë, për shkak se kjo çështje është zvarritur shumë. Është mirë me e marrë parasysh këtë, që në fund të dalim me një përfundim të mirë dhe me një rezultat të mirë, e jo vetëm me një fotografi ose me një mbledhje pa rezultat.

z.Basri Aliu: Përsëritet. Dihet që KAB-i është një procedurë fillestare, e cila mundet me pasë edhe ndryshime deri te miratimi i buxhetit. Por një pyetje e kam: a janë të kufizuara këto linja buxhetore që janë caktuar për shërbime, mallra, subvencione dhe investime kapitale? Për paga nuk kemi çka diskutojmë. A ka mundësi me pasë lëvizje ndërmjet këtyre kategorive? Sepse, duke pasur parasysh atë që e përmendën edhe Pernedni dhe Jakupi, për shkak të obligimeve të mëdha që kanë mbetur nga viti paraprak dhe çrregullimeve që kanë ndodhur për shkak të Kontratës Kolektive, kjo po e pengon edhe funksionalizimin e komunës në këtë drejtim. Kisha kërku që të shërbimet dhe mallrat të ketë një buxhet më të madh.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtoreshë, te faqja 16 ke një gabim teknik. Te Zyra e Kuvendit, te numri i punëtorëve figuron 27, prej tyre 8 femra dhe 19 meshkuj. Kjo është gabim; duhet të jetë 9 femra dhe 18 meshkuj. Për mua është shqetësim që investimet kapitale janë prapë në rënie. Tash, te pagat, a është planifikuar edhe një pjesë e rritjes, pasi prej 1 korrikut hyn edhe pjesa e rritjes së koeficientit prej 0.5, për shkak të pagës minimale 500 euro? Domethënë, nëse shkon paga minimale 500 euro, atëherë në këtë planifikim me siguri ministria e shton atë pjesë, mirëpo te pagat ndoshta na qet telashe në vitin e ardhshëm, sepse është llogaritur me gjendjen aktuale. Në momentin që paga minimale bëhet 500 euro, rritet koeficienti për 0.5 dhe ajo pjesë shkon te të gjithë. Kjo duhet me qenë në planifikim. Te Zyra e Kuvendit qenkan të planifikuara 12 mijë euro. Ne zakonisht kemi pasur 15 mijë euro. E dimë që vetëm kontrata e transmetimit na ka marrë diku 10 mijë euro, kështu që me bë një vizitë diku nuk e kemi mundësinë. Kisha kërku që kjo shumë me u rritë dhe me u bë minimumi 15 mijë euro. Nëse mbesin mjete, ne gjithmonë i kemi bartur, por kisha kërku që kjo me u rregullu. Edhe këtë që e përmendi Jakupi, është mirë me pas një vlerësim. Tash ne po i shtijmë te çështja e investimeve kapitale, por duhet me ditë sa kemi me i nda për me i pagu obligimet.

z.Illir Zuka: Kam edhe një propozim tjetër. Më mirë me pushu një vit me projekte të reja dhe me i kry ato që na kanë mbetë në gjysmë. Për shembull, e kemi rrugën “**Sabit Zuka**”, “**Haxhi Emini**”, kemi nisë veç 100 metra dhe ka mbetë si gërmadhë. Ua kemi vështirësu edhe njerëzve me hy në shtëpitë e tyre. E kemi rrugën te stadiumi, e cila është e shtime në plan prej vitit 2020. E kemi edhe rrugën te **Ibrahim Pira**, që 5–6 vjet po hyn çdo vit në projekt, por nuk po kryhet. Unë mendoj që më mirë me i kry këto që i kemi fillu dhe me e mbyllë një vit fiskal duke i përfundu krejt. Nuk është asgjë me hupë një vit fiskal për me i mbyllë të gjitha. Ti nuk mundesh me i thirrë qytetarët në dëgjime buxhetore kur projektet e vjetra janë ende në gjysmë. Si propozim i imi është që nuk kam çka me mbajt një takim në lagjen **Pira** ose **Zuka**, ku punët kanë mbetë në gjysmë. Çka me i thanë atij: “Hajde, se po e nisim një projekt të ri”, kur ende nuk janë kry projektet e vjetra? Si propozim, drejtoreshë, është mirë që edhe në Bordin e Drejtorëve me u diskutua kjo çështje. Unë kam propozim, edhe prej KPF-së, që projektet që janë në gjysmë të përfundohen dhe të mos fillohen projekte të reja pa u përfunduar ato.

zn.Milohate Ajeti, drejtoreshë: Jakup, te arsimi qysh është bërë qarkorja, qashtu janë bërë edhe kufijtë. Mirëpo ne prap, te grandit i përgjithshëm, gjithmonë ju ndihmojmë, sepse qashtu qysh janë kufijtë nuk kemi të drejtë me ju ndihmu. Mirëpo, me grandin e përgjithshëm dhe me të hyrat vetanake, gjithmonë e kqyrim sa e kanë mungesën dhe ua qesim prap. Edhe kjo kornizë, z. Basri, ndryshohet, sepse e kqyrim tash ku kemi më shumë nevojë. Ulemi, bisedojmë me drejtorët, ua dërgojmë planin, sepse kjo ndryshon. Ne e dërgojmë edhe në ministri dhe ndodh që na thonë: “Mallra dhe shërbime keni me i ndryshu, se nuk jua pranojmë.” Këtë e kemi pasur edhe vitin e kaluar, kur kemi pasur një problem për 37 mijë euro, por ndërkohë janë pajtuar dhe na e kanë kthyer prapë pozitivisht. Këto obligime që i kemi, nuk besoj që mundemi me i qitë në këto të reja që po flasim,

pa i pa paraprakisht sa i kemi krejt borxhet. Në ato kemi me i shti obligimet që i kemi, mandej çka mbetet, le të mbetet. Ne kemi diskutu këtë temë, që me i pagu obligimet. KAB-i i cakton kufijtë dhe ne nuk mundemi me i ikë atyre. Mundemi veç, brenda për brenda, me i zvogëlu investimet kapitale e me i qitë te mallrat dhe shërbimet. Këtë mundësi e kemi, sepse na e lejojnë. Edhe drejtori, që e diskutuam, gjithmonë thotë: "I ke 18 milionë euro, qiti ku të dush", me përjashtim të pagave dhe shtesave. Ne prapë kemi me bë ndryshime. Edhe te investimet kapitale kemi me i nxjerr disa obligime që i kemi, mandej edhe te mallrat dhe shërbimet, sepse kemi shumë obligime dhe kemi me i ndryshu.

z.Basri Aliu: Qëllimi im ka qenë që, për shkak të funksionalizimit të komunës, ato organet vitale të funksionojnë si duhet. Unë e di që keni vështirësi edhe në funksionet vitale, si për shembull furnizimi me karburante, rregullimi i automjeteve ose riparimi i rrugëve. Operatori hyn në punë, por nëse ti nuk e paguan, edhe ai ka me pas vështirësi. Më mirë kishte me qenë që te shërbimet dhe mallrat me pasë më shumë buxhet, në mënyrë që edhe obligimet dhe shërbimet për mallra që i kemi të mund t'i tejkaloni, por edhe funksionalizimi i komunës me ardhë në vendin e duhur.

z.Jakup Demiri: Te grandit i arsimit, që e përmenda, mua më është dukë shumë e madhe. Është problem me e mbulu atë shumë, edhe nëse ke nevojë, është problem me u mbulu edhe prej grandit të përgjithshëm.

zn.Milihate Ajeti, drejtoreshë: Grandi i arsimit është grand i vogël, dhe qysh na i japin ata kufijtë, ata i përcaktojnë. Na i japin ato kufij dhe ne nuk kemi çka bëjmë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i KomunësPërsëritet për të gjithë të pranishmit. Sa i përket asaj që e ka kërku Jakupi, a mund me pas informacion për obligimet që dalin nga komuna. Në aspektin e parë, obligimet që burojnë nga operatorët ekonomikë mund me u identifiku, sepse ata i kanë faturat, ndërsa burimi tjetër i marrjes së mjeteve që vjen prej Kontratës Kolektive nuk mundemi me e ditë saktësisht. Dhe kjo e dyta e ka kriju këtë barrë që e përmenda. Sepse marrja e mjeteve nga Kontrata Kolektive, komuna nuk ka qenë në dijeni për obligimet sa do të pasojnë. Janë marrë mjetet dhe ne jemi vonu te operatorët ekonomikë, dhe aty kemi pësuar edhe dënim. Komuna e Vitisë, por besoj edhe në mbarë Kosovën, i paguan dy dënime: një të Kontratës Kolektive dhe një të operatorëve ekonomikë që e kanë kry punën. Pikërisht kjo është ajo zvarritje, ku janë lidhë kontratat dhe nuk janë kry punët në terren. Ky cikël duhet me u përfunduar. Ne kemi insistu këtë vit për shpalljen e tenderëve për atë që kemi obligative, për me e mbajtur shoqërinë në proces, si për shembull mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërore, mirëmbajtja e shkollave, etj. Jemi kufizuar shumë në këto gjëra, por megjithatë kemi zbrit investimet kapitale dhe i kemi kaluar te mallrat dhe shërbimet. Duhet ta dini se nuk ka kryetar komune që dëshiron me i ul investimet kapitale, por është obligim që e imponon situata. Unë besoj që u ngritën edhe dy çështje: një për kryetarët e këshillave të fshatrave. Kur i kemi zgjedhë, i kemi vendos në përbërje ekzekutive dhe kuvendore. Këtë vit janë pjekë kushtet, për shkak se kemi pasë zgjedhje të shpeshta. Edhe pse gjithmonë kam thënë që kemi një funksionalitet të këshillave të fshatit në praktikë, në aspektin ligjor dhe institucional nuk është i rregulluar qartë. Sistemi i organizimit dhe ushtrimit të pushtetit është i ndarë në dy nivele: lokal dhe qendror, dhe për këtë arsye këta kanë mbetë në mëshirë të askujt. Kam pyetur edhe në Shqipëri, ku ata e kanë siguru një pagë dhe e kanë rregullu në aspekt ligjor. Tash, a është e vogël apo e madhe ajo pagesë është çështje tjetër, por tek ne ka mbetë e parregulluar. Disa komuna e kanë rregullu, por jo në mënyrë plotësisht konforme me ligjin. Besoj që pas pushimeve verore, me një vendim ku caktohet komisioni, mund të fillojmë procedurat në shtator ose tetor. Edhe pse konsideroj që mosrregullimi i pozitës së tyre në aspektin financiar është një demotivim i madh dhe do të ndikojë në rënie të interesimit, megjithatë ai proces duhet të përfundohet.

z.Jakup Demiri: Sa prej komunave e kanë shfrytëzuar një model të Ministrisë së Financave, sidomos në Ministrinë e Infrastrukturës, kanë dërgu projekte tu i kalu në Kuvend Komunal, kanë pas problem financiare, kanë dërgu edhe Kamenica edhe Gjilani. Kishte me qenë edhe kjo si model me qenë, që nuk kemi parë këtu me na mbështet prej qeverisë që me qenë si ekstra projekte.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E di që kemi dërguar disa kërkesa. Kryetari ka kërkuar edhe një takim në Ministrinë e Shëndetësisë për çështjen e QKMF-së. Tani, kur do të realizohet ai takim nuk e di, por ka qenë një lloj premtimi i kësaj qeverie gjatë zgjedhjeve të kaluara. Besoj se ai premtim qëndron ende dhe shpresoj që kjo të rezultojë me përfitimin e një QKMF-je të re për Komunën e Vitisë. Sa i përket asaj nëse ka logjikë të trajtohet kjo çështje në Kuvend, mua nuk më pengon. Nëse bëhet për të mirën e qytetarëve, atëherë duhet t'i shikojmë të gjitha mundësitë dhe pse të mos veprojmë. Së pari, uroj që të konstituohet qeveria dhe të fillojë funksionimi i plotë i institucioneve, në mënyrë që t'i shterojmë të gjitha mundësitë. Unë shumë herë kam thënë se edhe Komuna e Vitisë është fëmijë i Kosovës dhe meriton trajtim të barabartë, si çdo komunë tjetër.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend. Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, edhe kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2027

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E dimë që zakonisht në muajin qershor e kemi filluar procedurën për themelimin e komisionit, pasi ky proces zgjat rreth një muaj deri në marrjen e vlerësimit të ligjshmërisë, zhvillimin e debatit dhe përfundimin e procedurave të tjera. Edhe pse këtë vit nuk ka ndonjë ndryshim, është mirë që Kuvendi ta ketë gjithmonë të njëjtin plan veprimi. Kemi menduar që komisioni edhe këtë herë të përbëhet nga 7 anëtarë: përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të partive politike, unë si kryesues i Kuvendit dhe Fatlumi si sekretar i Kuvendit. Hap debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Meqenëse nuk ka diskutime, e hedh në votim. A jeni që kjo pikë të procedohet për në Kuvend? Konstatoj se pika miratohet me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim. Rrjedhimisht, kjo pikë procedohet për shqyrtim në Kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

4. Propozim për ndryshimin dhe plotesimin e vendimit me nr. 01-110/05-487 i datës 04.05.2026. për ndarjen e parcelës kadastrale në pronën komunale

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: E keni arsyetimin në material. Obligim i tyre është me i plotësu këto pika. Ligjshmëria e ka kthyer për shkak që nuk ka qenë i plotësum si dokumentacion material.

z.Ilir Zuka: Nuk e di që ka pas ndonjë propozim-vendim që ka pas ma shumë gabime ndonjëherë, prej vitit 2013 deri në 2026, sa janë pjesë e institucioneve komunale në Komunën e Vitisë. Me një propozim-vendim me ta kthyer vendimin e me të ardh me 7 pika, me 7 gabime, është e patolerueshme. Ne po dalim keq se ne po e votojmë. Jam për me kalu pa tjetër, por me të ardh me këto gabime nuk është në rregull.

z.Basri Aliu: Mesa e pashë unë, kjo ma shumë ish si pasojë e gjeodetit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Po shpresojmë që tani e kanë plotësu mirë. A jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në Kuvend. Ju falënderoj për kontributin e dhënë. Shihemi herave tjera.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi
